



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.454/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Eing Com” Sh.p.k - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan me datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–Komuna Lipjan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik "Eing Com" Sh.p.k – Prishtinë, që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik "Eing Com" Sh.p.k – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me 08.07.2020 me nr. 454/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica", me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59, 61, 65, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 të RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.07.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 24.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1, Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues se i rekomanduar për kontratë në pozicionet 1.3, 3.1, 5.4, 6.1, 8.1, ka ofruar çmime të cilat sipas OE ankues janë çmime Jo/Normalisht të ulëta, eksperti shqyrtues vlerëson se sipas nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues. Në rastin konkret AK-ja nuk e ka vlerësuar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta. Prandaj, ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me autorizimet e dorëzuara nga i rekomanduari për kontratë, për të cilin pretendon se i ka ofruar dy autorizime të cilat janë në kundërshtim me pikën 4.1 të FDT-së, ku AK-ja nuk ka lejuar variante.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se i rekomanduari për kontratë ka ofruar dy autorizime, njëri autorizim është i lëshuar nga "Falgo" si distributor dhe autorizimin tjetër nga prodhuesi "AVP Park". Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar dy autorizime, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se gjatë vlerësimit të ofertave AK-ja është dashur që konform nenit 72 të LPP-se ta sqaroj me OE të rekomanduar për kontratë dhe të vendoset përfundimisht se me produktet e cilit prodhues do të furnizohet AK-ja për faktin se në dosje të

tenderit AK-ja në piken 4.1 nuk ka lejuar variante. Lidhur me këtë çështje, eksperti shqyrtues vlerëson se përderisa dëshmia është konform kërkesës së DT-së nuk mund të eliminohet një operator ekonomik nga një aktivitet i prokurimit, që në rastin konkret i rekomanduari për kontratë e ka ofruar autorizimin sipas kërkesës së DT-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se katalogët të cilat i ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë, janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, me arsyetimin se katalogët janë në gjuhën turke. Eksperti shqyrtues, vlerëson si të paqëndrueshëm këtë pretendim për faktin se dy katalogët e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë janë edhe në gjuhën angleze. Megjithatë, eksperti shqyrtues sqaron se gjatë ri vlerësimit nëse komisioni ri vlerësues ka ndonjë paqartësi lidhur me gjuhën e përdorur në këto dokumente, atëherë mund të veproj konform përgjigjes numër 66 të publikuar në ëeb faqen e KRPP-së, e cila e ka sqaruar situatat se kur dhe për çfarë dokumente mund të kërkojnë të përkthehen.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me atë se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar dëshmi/garancion sipas përshkrimit të pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë, ku AK-ja ka kërkuar garancion në pozicionet nr.: 4.6, 5.4, 5.5 dhe 11.70.

Eksperti shqyrtues e vlerëson si të paqëndrueshëm këtë pretendim për faktin se te përshkrimi i çmimit nuk mund të vendosen kërkesat e kualifikueshmerisë për një operator ekonomik. Të gjitha kërkesat e kualifikimit vendosen tek pjesa e FDT-së dhe tek specifikacioni teknik i detyrueshëm.

Në fund, eksperti shqyrtues pretendimet e OE ankues i vlerëson si pjesërisht të qëndrueshme dhe i rekomandon AK-së, që gjatë ri vlerësimit të ofertave për pozicionet ku OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta, ti zbatoj procedurat e parapara në nenin 61 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 30.07.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë në pozicionet 1.3, 3.1, 5.4, 6.1, 8.1, ka ofruar çmime të cilat sipas OE ankues janë çmime Jo/Normalisht të ulëta.

Paneli Shqyrtues sqaron se “Rregullat për tenderët Jo-normalisht të ulët” nuk zbatohen për pozicione të caktuara por për tenderët të cilët në shikim të parë duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se kjo rregull gjen zbatim në rastet kur çmimi i ofruar është mbi 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm ose çmimi i ofruar është mbi 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët apo janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Andaj, autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave duhet ti ketë parasysh këta faktor me qëllim që të vlerësoj drejt nëse oferta e OE të rekomanduar për kontratë mund të trajtohet si tender me çmime jo-normalisht të ulëta.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë se autorizimet e dorëzuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, për të cilin pretendon se i ka ofruar dy autorizime të cilat janë në kundërshtim me pikën 4.1 të FDT-së, ku AK-ja nuk ka lejuar variante.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy autorizime, njëri autorizim është i lëshuar nga “Falgo” si distributor dhe autorizimin tjetër nga prodhuesi “AVP Park”. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar dy autorizime, dhe se AK gjatë vlerësimit të ofertave është dashur që konform nenit 72 të LPP-së ta sqaroj me OE të rekomanduar për kontratë se me produktet e cilit prodhues do të furnizohet AK-ja për faktin se në dosje të tenderit AK-ja në piken 4.1 nuk ka lejuar variante.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë se katalogët të cilat i ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë, janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, me arsyetimin se katalogët janë në gjuhën turke.

Paneli Shqyrtues sqaron se dy katalogët e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë janë edhe në gjuhën

angleze. Andaj, në bazë të nenit par. 4 të nenit 13 të LPP-së, operatorët ekonomik mund të paraqesin një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose Angleze.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi/garancion sipas përshkrimit të pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë, ku AK-ja ka kërkuar garancion në pozicionet nr.: 4.6, 5.4, 5.5 dhe 11.70. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se te përshkrimi i çmimit nuk mund të vendosen kërkesat e kualifikimit për një operator ekonomik. Të gjitha kërkesat e kualifikimit vendosen tek pjesa e FDT-së dhe tek specifikimi teknik i detyrueshëm.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, AK gjatë ri vlerësimit të ofertave obligohet të kërkoj sqarime shtesë në pajtim me nenin 72 të LPP-së lidhur me autorizimet e OE të rekomanduar për kontratë. Po ashtu, AK gjatë vlerësimit të tenderëve të analizoj çmimin e ofertave dhe të vlerësoj nëse duhet të veprojnë në pajtim me “Rregullat për tenderët Jo-normalisht të ulët”.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që me rastin e vlerësimit të ofertave të bëjë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK– Komuna Lipjan

1x1 OE “Eing Com” Sh.p.k – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina